



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr. ref.: RK495/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI69/13

Parashtrues

Hysen Muqa

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, të 25 majit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Hysen Muqa, me vendbanim në fshatin Vraniq, komuna e Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 132/08, të 30 dhjetorit 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, të 25 majit 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 27 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 132/08, të 30 dhjetorit 2008, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, të 25 majit 2011. Në bazë të këtyre vendimeve, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale kontraktim i përfitimit joproporcional, dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 18 muajsh.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 27 maj 2013, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI-69/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI-69/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (gjyqtar kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 6 qershor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 qershor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në afat sa më të shkurtër të dorëzojë në Gjykatë dëshminë që tregon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, të 25 majit 2011.
9. Më 24 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, të 25 majit 2011.
10. Më 16 tetor 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 30 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 132/08, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe pesë të akuzuar të tjerë, për veprën penale kontraktim i përfitimit joproporcional nga neni 270 i Kodit Penal të Kosovës. Parashtruesi u dënua me 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.
12. Prokurori publik i Qarkut në Prizren parashtroi ankesë ndaj Aktgjykimit P. nr. 132/08, të 30 dhjetorit 2008. Ankesa e prokurorit publik të Qarkut kishte të bënte me supozimin se *“dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë tejet të buta dhe se nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë nënvlerësuar rrethanat rënduese dhe propozohet që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarve t’u shqiptohen dënime më të larta”*.
13. Më 25 maj 2011, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur në bazë të ankesës së prokurorit publik të Qarkut në Prizren, nxori Aktgjykimin Ap. nr. 157/2009, me ç’ rast e refuzoi ankesën e prokurorit publik të Qarkut, si të pabazuar, me arsyetimin se *“gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt e ka aplikuar ligjin penal kur ka gjetur se të akuzuarit e tjerë dhe në këtë rast edhe parashtruesi i kërkesës kanë kryer veprën penale kontraktim i përfitimit joproporcional në bashkëkryerje nga neni 270 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata Supreme gjithashtu gjen se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë të drejta dhe në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprave të kryera...”*.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 132/08, i 30 dhjetorit 2008, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 157/2009, i 25 majit 2011, janë të kundërligjshëm, sepse bazohen vetëm në një kuazidëshmi të njëanshme, me ç’rast kanë vendosur në kundërshtim me dispozitën e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe që saktësohen me Ligj dhe me Rregullore.
16. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

17. Nga dokumentet e parashtruara nga parashtruesi, Gjykata konstaton që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor në pajtim me nenin 49 të Ligjit për arsye se Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovë, Ap. nr. 157/2009, parashtruesi e ka pranuar më 27 tetor 2011, ndërsa kërkesën e tij, në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese, e ka parashtruar më 14 maj 2013, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar rreth 1 vjet e gjysmë jashtë afatit kohor të përcaktuar me ligj.
18. Prandaj, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36.1 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 tetor 2013, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Kadri Kryeziu




Prof. dr. Enver Hasani